

VECLISI SEÇIM

Win e folla të subjekta politike
duroca të të politikologut
in tënë bag olan ataya da



Instituti
Demokrati
për Zhvillim



Zbërthimi i trendeve zgjedhore 2000-2010

Prishtinë
Shtator 2011

Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D)

**ZBËRTHIMI I TRENDEVE
ZGJEDHORE
2000-2010**

Prishtinë
Shtator 2011

Copyright © 2011. Demokraci për Zhvillim (D4D).

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç për citim të pjesëve të shkurtra për qëllime të kritikave apo vlerësimeve, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme ripërtëritëse, ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjet elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar, etj., pa lejen me shkrim të D4D.

Ky publikim është mundësuar me përkrahjen e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe Institutit për Komunitete të Qëndrueshme (ISC) përmes Programit për Fuqizimin e Shoqërisë Civile në Kosovë (K-CSSP). Opinione të shprehura në këtë publikim janë të D4D-së.

PËRMBAJTJA

Përmbledhje	6
Hyrje	8
Një dekadë e demokracisë	9
(R)evulucioni elektoral i Kosovës	9
Elektorati dhe pjesëmarrja në zgjedhje	11
Dyfishimi i elektoratit	11
Mospërputhja me regjistrimin e popullsisë	12
Pjesëmarrja në zgjedhje: Një funksion i politikës së lartë	13
Rezultatet e partive	15
PDK: Konsistenca	15
LDK: Ringjallja e ngadaltë pas rënies së thellë	16
AAK: Përpyqja për të thyer barrierën rajonale	17
Partitë e reja nuk janë më të reja	18
Beteja për vendet e fundit të rezervuara	20
Efektet e politikave kryesore të procesit zgjedhor	21
Më pak gra me meritë	21
Ende të varur në udhëheqës	23
Dukja e fletëvotimeve si problem	23
Listat e hapura çdoherë e më shumë çmohen nga votuesit	24
Votimi i shumëfishtë dhe fletëvotimet e dëmtuara	25
Fletëvotimet e pavlefshme: Përmirësim gradual	26
Pse akoma ekzistojnë fletëvotimet me kusht dhe ato me postë?	29

PËRMBLEDHJE

Në dekadën e parë të zgjedhjeve, sistemi zgjedhor, procesi dhe menaxhimi janë përkeqësuar. Ekspertët ndërkombëtarë dhe misionet vëzhguese kanë theksuar një trend përkeqësimi të procesit zgjedhor në Kosovë.

Pak vende në botë bëjnë kaq shumë ndryshime të sistemit zgjedhor brenda dhjetë viteve: lëvizjen nga listat e hapura në të mbyllura dhe anasjelltas, futjen e pragut zgjedhor (5%), zgjedhjen e drejt-përdrejtë të kryetarëve si pjesë e një ndryshimi thelbësor të sistemit të qeverisjes lokale, dhe duke debatuar pothuajse çdo vit nëse duhet të mbahet kuota gjinore apo nëse duhet krijuar zona zgjedhore.

Mund të krijohet përshtypja që Kosova debaton dhe shqyrton ndryshime të vërteta, mirëpo zakonisht proceset janë të orkestruara në atë mënyrë që të absorbojnë energjinë për ndryshime. Në këtë mënyrë arsyetohet mbajtja e formulës më të thjeshtë që jep parashikueshmëri më të madhe për skenën politike në Kosovë.

Varësia e skajshme tek bashkësia ndërkombëtare dhe mësimi i ngadalshëm i institucioneve kosovare, janë tipare dalluese të dekadës së kaluar. ‘Kosovarizimi’ i dy palë zgjedhjeve të fundit praktikisht ka nënkuptuar që Kosova ka filluar të paguajë për zgjedhjet nga buxheti i saj dhe të marrë përgjegjësinë për dështim. Për fat të keq, kosovarizimi nuk ka përfshirë një transferim të njohurisë dhe ekspertizës zgjedhore nga partnerët ndërkombëtarë me përvojë më të madhe.

Shpeshësia e ndryshimeve është e kuptueshme pasi që çdo proces i ri i ka nevojë për reflektim dhe korrigjim për t’u përshtatur. Disa parti janë duke u përpjekur për të kuptuar se si të përshtaten më këto ndryshime, përderisa disa të tjera e kanë perfeksionuar sistemin mjaft mirë, madje tepër mirë në disa aspekte.

Proceset e deritanishme të diskutimeve për kërkimin e sistemit të duhur zgjedhor janë drejtuar tërësisht nga bashkësia ndërkombëtare dhe udhëheqësit kryesor me qëllim për të vendosur elemente që konsolidojnë skenën ekzistuese politike. Në të kaluarën një gjë e tillë u shfaq me aplikimin e pragut zgjedhor, edhe pse skena politike Kosovare nuk ishte e pjekur në konsolidim. Përkundrazi, kosovarët vazhdimisht kanë shprehur vullnetin për të kërkuar alternativa të reja të cilat i dëshpëronin më vonë.

Në aspekt të trendeve numerike, elektorati i Kosovës pothuajse është dyfishuar, kryesisht për shkak të regjistrimit të diasporës dhe komunitetit serb në vitet e para të pasluftës. Elektorati ka vazhduar të rritet me një mesatare prej 50.000 njerëzve në vit, që është më shumë se dyfishi i shtimit natyror. Një krahasim me regjistrimin e popullsisë të vitit 2011 sjell tek konkludimi se rreth 330.000 banorë nga lista e votuesve nuk janë në mesin e të gjallëve ose jetojnë jashtë vendit, dhe ky numër do të rritet çdo vit.

Me kohë, skena politike është përqendruar rreth partive më të konsoliduara. PDK-ja ka mbajtur një bazë të vazhdueshme të votuesve. LDK-ja ka pësuar një rënie gjatë kohës sa ishte në pushtet, ka

rënë drastikisht kur disa grupe e ndanë elektoratin e saj në vitin 2007, por ka filluar të këndellet paksa së fundmi. Trendi i AAK-së është varur nga prania e liderit të saj në vend. Tërësia e votave të tri partive të mëdha si proporcion i totalit ka pësuar rënie, së pari duke zvogëluar pjesëmarrjen e përgjithshme në votime e pastaj duke shkuar tek partitë e reja të ndryshme. Disa parti të reja fituan zemrat e votuesve të dëshpëruar që qëndruan larg tri partive të mëdha, por asnjëra nuk i'a arriti që t'i mbajë ata, të cilët i braktisën për parti edhe më të reja në zgjedhjet pasuese. Zgjedhjet e fundit të vitit 2010 jo vetëm që shënuan fundin e dekadës së parë të eksperimenteve kosovare me demokraci, por ato sollën edhe tri risi:

- (a) Fundin e trendit të rënies së LDK-së;
- (b) Ngritjen e një partie të re që dallon ndjeshëm nga opsionet e 'reja' të mëhershme;
- (c) Fundin e trendit ku vota serbe lidhet me statusin dhe fillimi i një ngritje të pjesëmarrjes së tyre afatgjate.

Përqindja e grave të zgjedhura me meritë ka rënë nga viti 2007 në 2010 dhe ky trend duhet të hulumtohet. Mundësia për të monitoruar numrin e zgjedhjes së tyre me meritë do të tregojë momentin kur Kosova është e gatshme që të zgjedh gratë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe do t'u jep më shumë legjitimitet së paku atyre grave që kanë hyrë në Kuvend falë votave të tyre.

Me mundësi që të votohet deri në persona, më shumë se 2/3 e votuesve e kanë zgjedhur edhe liderin po ashtu. Kjo mund të dëshmojë se një zonë e vetme zgjedhore u shkon për shtati liderëve. Është interesant të theksohet se e vetmja parti që udhëhiqet nga një lider që nuk e ka themeluar partinë e ka votuar atë në përqindjen më të lartë.

Thjeshtësia e sistemit zgjedhor kryesisht lidhet me pamjen e fletëvotimit. Çuditërisht, Kosovës shpesh i është këshilluar që të zgjedhë një sistem zgjedhor të thjeshtë por me fletëvotime të komplikuar. Është thelbësore që sistemi të jetë i thjeshtë për votuesit (p.sh. emrat në fletëvotime), madje edhe nëse një gjë e tillë komplikon menaxhimin e zgjedhjeve. Pasi që Kosova ka mjaft kohë para zgjedhjeve të ardhshme, me planifikim të kujdesshëm, KQZ-ja do të mund t'a zinte hapin. Pasojat e një zone të vetme zgjedhore ka rezultuar me pamundësinë e vendosjes së emrave në fletëvotim. Në përdorim të kombinuar me votën preferenciale (votimin e shumë emrave) ka pasur për pasojë që shumë votues kanë lënë emra të zbrazëta, të cilët komisionerët i kanë parë të arsyeshme që t'i plotësojnë vetë.

Numri i madh i votave të pavlefshme në vitin 2007 duhet të shërbejë si një mësim që nuk duhet mbajtur disa zgjedhje në të njëjtën ditë. Po ashtu, përqindja e votave të pavlefshme ka rënë përgjatë viteve, që sjell tek përfundimi se listat e hapura paraqesin problem shumë më të vogël sesa që paraqet vota preferenciale. Pothuajse gjysma e deputetëve të partive të mëdha janë zgjedhur vetëm falë listave të hapura, një tregues i qartë i dallimeve në preferenca në mes votuesve dhe liderëve të partive që hartuan listat.

Ne shpresojmë që kjo përpjekje e parë për të analizuar trendet zgjedhore të vitit 2010 do të kontribuojë në debatin aktual për reformimin e sistemit zgjedhor. Zbërthimi i trendeve zgjedhore merr kohë duke pasur parasysh të dhënat jo të plota të publikuara nga autoritetet dhe të paraqitura në formate të ndryshme nga viti në vit.

Të dhënat e paraqitura në këtë studim janë vetëm fillimi i një studimi gjithëpërfshirës që duhet bërë për t'i informuar partitë politike mbi zbrazësitë dhe vështirësitë, sikurse edhe përparësitë dhe mangësitë e formave të ndryshme zgjedhore që Kosova i ka provuar në të kaluarën. Në mungesë të një reflektimi të tillë të detajuar, autoritetet zgjedhore dhe vendimmarrësit nuk do të jenë në gjendje të shmangin vështirësitë që mund të fshihen në përpjekjet tona të ardhshme për krijimin e një shoqërie demokratike.

HYRJE

Kosova ka kompletuar një dekadë të demokracisë zgjedhore. Nga 2000 në 2010, Kosova ka mbajtur katër palë zgjedhje për Kuvend, katër të tjera për kuvende komunale dhe dy palë zgjedhje për kryetarë komunash. Dhjetë vite janë pak për të vëzhguar evoluimin e proceseve zgjedhore sepse ato tentojnë të ndryshojnë ngadalë. Demokracia zgjedhore e Kosovës nuk ka ndërtuar akoma bazë të qëndrueshme. Ka pasur aq shumë ndryshime të shpeshta sa është e vështirë që të dallohen efektet nga faktorët ndërhyrës.

Rrjedha e 12 palë zgjedhjeve (në shtatë vite zgjedhore) ofron një bazë për analizë fillestare. Ka pak hulumtim të pavarur në këtë temë, dhe pjesa më e madhe e kërkimeve bëhet nga institucionet ndërkombëtare si OSBE, IFES dhe NDI që shërbejnë si qendra të vetme të mendimit për autoritetet publike. Viti 2011 është viti i parë jo-zgjedhor në një periudhë të gjatë, dhe pasi që ky vit e përmbyll një dekadë të zgjedhjeve, është kohë e përshtatshme që të bëhet një analizë më gjithëpërfshirëse.

Disa aspekte duhet të shqyrtohen me kujdes: procesi zgjedhor, menaxhimi i KQZ-së, ligji i zgjedhjeve dhe sistemi, perceptimi publik dhe marrëdhëniet me përfaqësuesit e tyre dhe trendet zgjedhore. Kjo analizë e parë fillon me një analizë paraprake të trendeve kryesore dhe do të vazhdoj tutje me analiza shtesë.

Një rishikim i kujdesshëm i trendeve është i dobishëm për të iniciuar një debat gjithëpërfshirës dhe që është i bazuar në fakte dhe shifra. Trendet mund të ilustronë proceset dhe rezultatet që nuk mund të vërehen me sy. Së bashku me punimet tjera që do të publikojë D4D, ne tentojmë që të thellojmë procesin dhe t'u ndihmojmë të zgjedhurve tanë që të vendosin bazuar në më shumë opione sesa në hulumtimet e jashtme në të cilat shpesh varen ata.

Vlerësimet në tri vitet e fundit të Komisionit Evropian, se autoritetet e zgjedhjeve në Kosovë kanë bërë 'progres të kufizuar' janë shqetësuese sikurse janë shqetësuese edhe rastet e shumta të shkeljeve zgjedhore. Zëra të tjerë të pavarur kanë qenë edhe më kritik, prandaj nuk ka dyshim që institucionet menaxhuese duhet të jenë më të vëmendshme për të përmirësuar së paku pikat e dobëta që kanë qenë mirë të dokumentuara.

Të dhënat që ofrohen nga KQZ-ja shpesh janë jo të plota dhe paraqiten në formate që e bëjnë krahasimin e vështirë, të shtrenjtë dhe marrin kohë. Pak organizata kanë llogari të bëjnë futjen e një numri enorm të shifrave nga formati PDF me të dhëna të përgjysmuara në baza të të dhënave kuantitative, prandaj ka mungesë të studimeve që do të ndihmonin në kuptimin e përvojës tonë zgjedhore.

Analiza e trendeve e paraqitur më poshtë merr në konsideratë ndryshimet përgjatë viteve që kanë ndikuar më së shumti procesin zgjedhor. Studimi fillon duke shikuar aspektet më themelore të procesit zgjedhor siç janë lëvizja e elektoratit, mbajtja e listës së votuesve, sikurse edhe trendet e votave të pavlefshme, me postë si dhe atyre me kusht. Trendet e përgjithshme të partive janë të analizuara, më pastaj të pasuara me një shqyrtim të varësisë së tyre tek liderët, ndikimit të listave të hapura dhe në fund bëhet krahasimi i numrit të deputeteve femra të zgjedhura me meritë kundrejt atyre me kuotë.

Të dhënat e paraqitura në këtë studim janë vetëm fillimi i një studimi krahasues që duhet të bëhet në mënyrë që të informohen partitë politike mbi mangësitë dhe zbrazësitë, sikurse përparësitë dhe mangësitë e formave të ndryshme zgjedhore që Kosova i ka provuar në të kaluarën. Pa një reflektim të detajuar, autoritetet zgjedhore dhe vendimmarrësit do të kenë pak mundësi për të parandaluar rreziqet që fshihen në të ardhmen. D4D do të vazhdojë të hulumtojë më thellë dhe do të paraqesë më shumë të dhëna në publikimet e ardhshme. Trendet që janë paraqitur këtu do të nxisin një diskutim më kualitativ në atë se çfarë reformash i duhen Kosovës në të ardhmen, për sistemin e saj zgjedhor si dhe për procesin në përgjithësi.

NJË DEKADË E DEMOKRACISË

Zgjedhjet e para lokale në Kosovë u organizuan në tetor të vitit 2000, nën administrimin e UNMIK-ut. OSBE-ja, shtylla e tretë e UNMIKU-t, morri rolin udhëheqës për të organizuar, financuar dhe administruar zgjedhjet që do themelonin autoritetet qeverisëse të para demokratike në Kosovë. Që na ajo kohë, kuvendet komunale kanë kaluar nëpër testin zgjedhor edhe tri herë të tjera (2002, 2007 dhe 2009). Zgjedhjet e para për kuvende komunale pas shpalljes së pavarësisë të mbajtura në vitin 2009 rezultuan me themelimin e komunave të reja të Graçanicës, Ranillugut, Klllokotit, Junikut, Mamushës dhe Hanit të Elezit.

Zgjedhjet e para qendrore që shpion në krijimin e Kuvendit të Kosovës u mbajtën në nëntor të vitit 2001, pastaj në 2004, 2007 dhe tash së voni në vitin 2010. Të gjitha legjislaturat kanë aplikuar një kuotë gjinore prej 30%. Mundësia e votuesve për të ndikuar në listat e partive përmes mundësisë së re të listave të hapura ka qenë jo aq e mirëpritur nga udhëheqësit e partive dhe menaxhmenti i zgjedhjeve. Fatkeqësisht, Kosova sërish përballet me presione kërcënuese për të hequr listat e hapura.

Zgjedhjet 2000-2010			
Viti	Zgjedhjet Qendrore	Zgjedhjet për Kuvende Komunale	Zgjedhjet për Kryetar Komune
2000		X	
2001	X		
2002		X	
2004	X		
2007	X	X	X
2009		X	X
2010	X		

(R)evolucioni elektoral i Kosovës

Një fushatë e madhe për të ndryshuar sistemin zgjedhor u ndërmor gjatë viteve 2003-2004, duke shpie në ndryshime thelbësore në kornizën zgjedhore të vitit 2007. Një pikë kthese në zgjedhjet kosovare ndodhi në vitin 2007 kur për herë të parë Kosova i futi listat e hapura për zgjedhjet komunale dhe zgjedhjen e drejtpërdrejtë të kryetarëve të komunave. Përveç këtyre përmirësimeve për të cilat shoqëria civile e Kosovës avokoi fuqishëm, Kosova po ashtu bëri edhe hapa prapa. Futja në përdorim e një pragu zgjedhor prej 5% (nga viti 2007) filloi konsolidimin e partive në kohën kur Kosova kishte nevojë për dinamizëm më të fortë dhe ndryshime të tjera. Ishte e drejtë që në mungesë të zonave zgjedhore të futej “vota e shumëfishhtë” (preferenciale), megjithatë nuk u morën masat e domosdoshme për të parandaluar vjedhjen e votave.

Dy palë zgjedhjet e fundit (zgjedhjet lokale të vitit 2009 dhe ato qendrore të vitit 2010) janë financuar nga buxheti i Kosovës me rol të madh të vendorëve. Edhe pse nuk ka financuar më zgjedhjet, angazhimi i OSBE-së ka mbetur thelbësor por vetëm në prapaskenë dhe pa përgjegjësi zyrtare. Përveç kësaj, këto dy palë zgjedhje po ashtu u karakterizuan nga parregullsi të shumta dhe publikimi i rezultateve u vonua për shkak të rivotimit në komuna të caktuara, verifikimit të votave me kusht dhe marrjes së vendimeve për një numër të shkeljeve. Në zgjedhjet lokale të vitit 2009, KQZ-ja udhëzoi rivotimin në katër komuna (119 qendra të votimit), Prizren, Lipjan, Gjilan dhe Mitrovicë përdërisa në vitin 2010 KQZ-ja urdhëroi përsëritjen e votimeve në pesë (5) komuna (94 qendra të votimit), Skenderaj, Drenas, Mitrovicë, Deçan, Malishevë.

Zgjedhjet e para të pasluftës për kuvende komunale në vitin 2000 filluan me një sistem të listave të hapura. Votuesit e kishin mundësinë për të zgjedhur një kandidat nga lista e partisë së tyre të preferuar, opSION i cili u hoq për zgjedhjet pasuese kur Kosova futi në përdorim listat e mbyllura.

	2000	2001	2002	2004	2007	2009	2010
Lloji i zgjedhjeve	Kuvende Komunale	Qendrore	Kuvende Komunale	Qendrore	Qendrore Kuvende Komunale Kryetar Komune	Kuvende Komunale Kryetar Komune	Qendrore
Listat	Listat e hapura	Listat e mbyllura			Listat e hapura		
Mundësitë	Një mundësi				1+10 mundësi	1+1 mundësi	5 mundësi
Pragu	Pa prag				5% (për qendrore)	Pa prag	5%
Kryetar	Nga Kuvendi Komunal	N/A	Nga Kuvendi Komunal	N/A	Drejtperdrejtë		N/A
Zonat	N/A	Vetëm një zonë	N/A	Vetëm një zonë		N/A	Vetëm një zonë

Presioni publik tregoi një pakënaqësi të qartë për të lejuar liderët e partive që nuk kanë demokraci të brendshme për të vendosur për listat e kandidatëve për deputetët e Kuvendit të ardhshëm. Transformimi kryesor ndodhi para zgjedhjeve të vitit 2007 kur u futën listat e hapura dhe u bë zgjedhja e drejtperdrejtë e kryetarëve të komunave. Kjo praktikë ishte ndjekur për zgjedhjet lokale të vitit 2009 dhe zgjedhjet qendrore të vitit 2010, por me një zvogëlim të mundësisë për përzgjedhje preferenciale prej 10 në 1, përkatësisht në 5.

Në mungesë të vullnetit politik për të krijuar zonat zgjedhore, listat e hapura me një mundësi të vetme për të zgjedhur u panë si të papërshtatshme. Perceptimi se elektorati është i obsesionuar me liderët e partive krijonte përshtypjen se kandidatët lokal do t'a kishin të vështirë për të konkurruar. Duke mos pasur mundësi për publicitet në media, qasje në fonde apo mundësinë për të garuar në zona zgjedhore, u vendos që për zgjedhjet qendrore dhe lokale të vitit 2007 votuesve tu jepet mundësia të zgjedhin deri në 10 kandidatë të ndryshëm brenda partisë së njëjtë. Pasi që tri palë zgjedhje u mbajtën në të njëjtën ditë, votuesit mund të bënin deri në 23 përzgjedhje (1 kryetar, 1 parti + 10 kandidatë për zgjedhje qendrore, dhe 1 parti + 10 kandidatë për kuvendin komunal). Konsideratat për përfaqësim gjinor kanë ndikuar në mbajtjen jo edhe aq të pëlqyeshme të votës preferenciale për më shumë se dy palë zgjedhje. Sidoqoftë, për zgjedhjet e ardhshme, mundësia e votës preferenciale duhet të hiqet duke pasur parasysh që në zgjedhjet e fundit u dëshmuua që pikërisht kjo votë ka dhënë mundësi për vjedhje masive brenda partive politike gjë që solli pakënaqësi jo vetëm të votuesit e rregullt, por edhe tek lojalistët e partive.

Për dy mandatet e para, kuvendet komunale kanë zgjedhur vetë Kryetarët e tyre, përderisa në dy mandatet e tjera duke filluar nga viti 2007 filloi zgjedhja e drejtperdrejtë e kryetarëve të komunave me fuqi ekzekutive (në vend të kryeshefave ekzekutive). Kryetarët zgjidhen me një sistem dy-raundesh, ku dy kandidatët me numrin më të madh të votave vazhdojnë në balotazh.

ELEKTORATI DHE PJESEMARRJA NË ZGJEDHJE

Dyfishimi i elektoratit

Madhësia e elektoratit ka qenë vazhdimisht një nga çështjet më kundërthënëse. Në vitin 2010 numri i elektoratit ka qenë 1.632.276 (persona të moshës 18 vjeçare e përmbi) dhe 75,6% më i madh sesa

elektorati i zgjedhjeve të para të vitit 2000. Kjo nuk paraqet në mënyrë korrekte numrin e njerëzve me të drejtë vote pasi që shumë nga të vdekurit vazhdimisht figurojnë në listën e votuesve, sikurse figuron edhe diaspora. Dy vitet e para shënuan një ngritje të madhe të elektoratit me mbi 400.000 votues të rinj të cilët kryesisht mund t'i atribuohen regjistrimit të diasporës dhe komunitetit serb krahas shtimit natyror të atyre që e kanë arritur moshën për të qenë votues. Përgjatë këtyre viteve lista e votuesve u rrit më shpejt sesa shtimi natyror, kryesisht për shkak se në të vetëm janë futur votues të rinj dhe shumë pak emra të personave të vdekur janë fshirë.

Madhësia e Elektoratit




Figura 1: Numri i personave me drejtë vote.

Rritja e mëvonshme ndërmjet vitit 2002 dhe 2004 tregon shtimin natyror (për të cilin demografët thonë që është rreth 30.000 persona në vit) dhe mbi 15.000 të tjerë që sipas të gjitha gjasave janë

Ndryshimi i elektoratit ndër vite		
2001-2000	336,808	Regjistrimi i diasporës dhe një pjesë të komunitetit serb
2002-2001	70,494	
2003-2002	46,099	Votuesit e ri të regjistruar, me shumë pak pastrim të listës nga emrat e personave vdekur (numër i cili është rritur përgjatë viteve për shkak se pastrimi i listës së votuesve nuk ka nënkuptuar edhe pastrimin e regjistrimit civil nëpër komuna).
2004-2003	46,099	
2005-2004	51,670	
2006-2005	51,670	
2007-2006	51,670	
2008-2007	-1,975	Heqja e të vdekurve nga lista në disa komuna
2009-2008	-1,975	
2010-2009	68,535	Votuesit e ri të regjistruar pa heqjen e të vdekurve

emra të personave të vdekur që asnjëherë nuk janë fshirë. Rritja është pothuajse dy herë më e lartë sesa shkalla e kosovarëve që arrijnë moshën për të votuar.

Komunat mbajnë regjistrat e tyre civil të cilët më pastaj shkojnë në Regjistrin Qendror në Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB). Kur bëhen përgatitjet për zgjedhje, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ)

e merr atë nga MPB. Emrat e personave të vdekur që janë fshirë nga lista e votuesve nga KQZ nuk largohen nga regjistrat komunal që përdoren për zgjedhjet vijuese. Në këtë mënyrë elektorati ka vazhduar të rritet edhe më shumë, nga një mesatare prej 46.099 (2002-2004) në 51.670 në (2004-2006) duke shkuar deri në 68.535 (2009-2010). Kjo tregon që disa njerëz që janë fshirë nga lista e votuesve në vitin 2009 janë kthyer sërish në listën e votuesve të vitit 2010.

Viti i vetëm kur KQZ-ja ka bërë një pastrim më të mirë të listës nga personat e vdekur ka qenë viti 2009. Sidoqoftë, duket se për zgjedhjet 2010, gjatë përgatitjeve për zgjedhjet qendrore, shumica e njerëzve që ishin fshirë nga lista i janë shtuar listës sërish duke shtuar rreth 70.000 votues brenda një viti (dy herë më shumë sesa numri i lindjeve), përndryshe nuk ka ndonjë shpjegim tjetër se si ka ardhur deri tek një gjë e tillë. Mund të vihet në përfundim që KQZ-ja nuk e ka dërguar listën e pastruar sërish tek MPB-ja dhe komunat për përditësim, dhe pastrimi i bërë nga KQZ është i pamjaftueshëm dhe jo-efikas.



Figura 2: Ndryshimi vjetor i elektoratit nga 2000 në 2010.

Këto vlerësime shpijnë tek një konkludim i përafërt se rreth 3.000 njerëz të vdekur, rishtazi i janë shtuar listës së votuesve krahas të rinjve që kanë arritur moshën për të votuar dhe krahas emrave të personave të vdekur që janë bartur në listën e votuesve nga viti në vit. Enti i Statistikave të Kosovës raporton rreth 7.000 persona të vdekur në vit, që nënkupton se rreth 4.000 vetë ndoshta largohen nga komunat dhe 3.000 të tjerë mbesin.

Jo të gjitha komunat kanë pësuar rënie në elektorat gjatë vitit 2009. Në fakt, disa prej tyre pësuan ngritje për rreth 4%, gjë që tregon se pastrimi nuk ishte i njëtrajtshëm nëpër komuna. Prishtina ka pasur rënie prej 12% ose më shumë se 21.000 votues në listën e votuesve, Kaçaniku dhe Peja patën një rënie prej 6.000 votuesish. 12 komuna patën ngritje në elektorat madje edhe pas pastrimit, Drenasi dhe Malisheva patën ngritjen më të madhe nga të gjitha komunat, me nga +3,9% secila.

Mospërputhja me regjistrimin e popullsisë

Të dhënat paraprake nga regjistrimi i popullsisë i bërë në pranverë të vitit 2011 tutje ilustrojnë mospërputhjet e elektoratit real me listën e votuesve. Dallimet e evidentuara nga regjistrimi i popullsisë tregojnë probleme serioze me listën e votuesve dhe potencialisht ndoshta edhe me të dhënat e regjistrimit. Numri i përgjithshëm i per-

Banojnë në Kosovë > 18 vjeçarë		
	1,733,872	Persona të regjistruar sipas numrimit të popullatës (pa përfshirë serbët e veriut dhe diasporën)
-	476,815	Nën moshën 18 vjeçarë (25-30%) përafërsisht
=	1,257,057	Përafërsisht numri i elektoratit aktiv pa serbët nga veriu
Fryrja e elektoratit		
	1,632,276	Elektorati në vitin 2010 nga lista e votuesve
-	1,257,057	Përafërsisht numri i elektoratit aktiv pa serbët nga veriu
-	≈ 40000	Serbët nga veriu i Kosovës
=	335,219	Llogaritja e numrit të personave që gjenden në listën e votuesve por që nuk votojnë (të vdekur dhe diaspora)

sonave të regjistruar është 1.733.872; i tëri vetëm 6% më i madh sesa lista e votuesve të vitit 2010 (e cila për dallim nga regjistrimi i popullsisë nuk përfshin personat nën moshën 18 vjeçare). Përderisa popullata serbe në veri të Kosovës ka bojkotuar regjistrimin dhe diaspora nuk është përfshirë në të, rezultati qartazi tregon që elektorati është shumë më i vogël sesa që e paraqet lista e votuesve.

Përveç disa problemeve të asocuara me regjistrimin e popullsisë të vitit 2011, kjo është edhe një tregues se lista e votuesve të vitit 2010 është ndjeshëm e fryrë në krahasim me trupin real votues.

Demografët vlerësojnë se ndërmjet 25-30% e popullatës është nën moshën 18 vjeçare, që i bie që nuk kanë të drejtë vote. Nëse kjo pjesë i hiqet numrit total të popullatës së regjistruar, numri total i elektoratit sillet rreth 1.250.000 (duke përfshirë përafërsisht rreth 40.000 serbë që nuk kanë marrë pjesë në regjistrim në veri). Ky vlerësim shpie në përfundimin se lista e votuesve e vitit 2010 ka qenë e fryrë për më shumë se 335.000 njerëz, e cila në masë të madhe përbëhet nga diaspora dhe emrat e personave të vdekur që nuk janë hequr nga lista gjatë periudhës 2000-2010.

Pjesëmarrja në zgjedhje: Një funksion i politikës së lartë

Për një kohë të gjatë trendi më shqetësues në zgjedhjet e Kosovës ka qenë rënia e pjesëmarrjes në zgjedhje. Zgjedhjet e para të organizuara pas luftës, ato lokalet të vitit 2000, kishin një pjesëmarrje prej 79% të elektoratit, një përqindje që ishte arritur kryesisht për shkak të elektoratit të vogël. Kjo është arsyeja pse ne kemi vendosur që në rend të parë ta paraqesim pjesëmarrjen në votime me numra absolut (edhe pse në përgjithësi ajo duhet të paraqesë përqindjen e elektoratit që ka votuar). Për shkak të rritjes së elektoratit në mënyrë jo proporcionale në dy vitet e para, edhe përmirësimi i pjesëmarrjes në zgjedhje në vitin 2001 (në numra absolut) paraqet një rënie të ashpër kur paraqiten në shifra të përqindjes.




Figura 3: Numri i votave për zgjedhje lokale, kryetarë komunash dhe zgjedhje qendrore 2000-2010.

Në vitin 2001, më shumë se 60.000 serbë që jetonin në Serbi dhe Mal të Zi votuan për zgjedhjet qendrore të Kosovës të atij viti dhe elektorati përmbante më shumë se 105.000 votues të tillë të regjistruar.

Një rënie shqetësuese, madje edhe në numra absolut, ndodh nga viti 2002 e vazhdon deri në vitin 2007. Pjesëmarrja e vogël nën 40% të votuesve të regjistruar shpjegohet nga pakënaqësia masive me qeverisje dhe mungesë të progresit të shtetësisë së Kosovës. Është interesante të theksohet që në zgjedhjet e vitit 2007 edhe pse ishin mbajtur në të njëjtën ditë, ka pasur një dallim në rreth 60.000

vota në pjesëmarrjen për zgjedhje qendrore, krahasuar me ato për kuvende komunale. Faktet nuk janë të plota, megjithatë ka pak mundësi tjera që e shpjegojnë një gjë të tillë përveç vjedhjes së votave.

Pjesëmarrja në zgjedhje u përmirësua paksa në zgjedhjet e para pas shpalljes së pavarësisë, megjithatë në aspekt të numrave ajo ishte akoma më e ulët sesa numri i votuesve në vitin 2001 apo 2002.

Në zgjedhjet qendrore të vitit 2010, 15 komuna pësuan një rënie të pjesëmarrjes në votime, ku Mitrovica pësoi rënien më të madhe prej 7,8% krahasuar me pjesëmarrjen në zgjedhje për kuvende komunale në vitin 2009.

Në anën tjetër, pjesëmarrja në zgjedhje u rrit në 21 komuna me rritjen më të madhe në Prishtinë (9,8%). Novobërda dhe Graçanica kanë pasur pjesëmarrjen më të lartë të votuesve në zgjedhjet e vitit 2010, përkatësisht 24,8% dhe 22,5%, që shpjegohet me ndryshim të qëndrimit të serbëve të Kosovës që votuan më së shumti që nga zgjedhjet e vitit 2001. Rritja më e madhe e pjesëmarrjes në votime në këto tri palë zgjedhje (2007-2010) është shënuar në Skenderaj, Drenas, Lipjan, Kaçanik dhe Prishtinë (në tri nga to është ripërsëritur procesi i votimit, Skenderaj dhe Drenas në vitin 2009 dhe 2010 dhe në Lipjan në zgjedhjet lokale të vitit 2009). Sidoqoftë, edhe pas përsëritjes së votimit në Skenderaj dhe Drenas, pjesëmarrja e tyre në zgjedhje ka shkuar gati në 60%, ndjeshëm më lartë sesa mesatarja në nivel vendi.

Ka një dallim të madh prej rreth 60.000 votash ndërmjet pjesëmarrjes në zgjedhje qendrore dhe ato lokale të mbajtura në të njëjtën ditë.

REZULTATET E PARTIVE

Përshkrimi i shkurtër i performancës së partive përgjatë 10 viteve nuk mjafton, megjithatë objektivi i këtij publikimi nuk lejon një analizë të thellë në këtë moment.

PDK: Konsistenca

Partia që ka arritur të mbajë votuesit e saj në mënyrën më të disiplinuar gjatë dekadës së fundit është Partia Demokratike e Kosovës (PDK). Edhe pse elektorati i saj ka variuar nga 188.000 votues në zgjedhjet e vitit 2000 në më shumë se 235.000 në zgjedhjet për kryetar komune në vitin 2009, ajo është partia e vetme që në përgjithësi ka një trend stabil.

PDK ka pasur një rënie të vogël në vitin 2007, por rënia ka qenë më e vogël sesa rënia e përgjithshme e pjesëmarrjes në votime, kështu që performanca e saj si pjesë e totalit nuk ka pësuar. Elektorati i PDK-së ka qenë dukshëm më konsistent dhe ka marrë pjesë në zgjedhje madje edhe në rastet kur pjesa tjetër e elektoratit ka pasur pakënaqësi. Pjesëmarrja e përgjithshme e ulët në zgjedhje i ka dhënë një shtytje PDK-së, dhe ajo e ka përdorur të qenurit e saj në opozitë nga viti 2004 në 2007 për t'i fituar zgjedhjet në vitin 2007.

Çuditërisht, vitet në pushtet të PDK-së kanë rezultuar gjithashtu me më shumë vota. Pakënaqësia e gjerë e raportuar nga Paralajmërimet e Hershme të UNDP-së e dëshmojnë që votat e shumta nuk kanë ardhur si rezultat i qeverisjes së mirë por si rezultat i aftësisë së saj për të përdorur resurset publike dhe premtimet joreale për investime kapitale si asete elektorale. Në dy palë zgjedhjet e fundit PDK-ja ka ngritur numrin e votave në mënyrë të ndjeshme pavarësisht anulimit të votave në disa komuna.

Suksesin më të madh PDK-ja e ka shënuar në vitin 2009 gjatë garës për kryetarë komunash kur në total i ka pasur rreth 11.000 vota më shumë sesa në garën për kuvende komunale në të njëjtin vit. Kjo kryesisht ka ndodhur për shkak të performancës së mirë të kandidatëve të saj në Prizren, Vushtrri, Skenderaj dhe Podujevë.

Përkrahësit e zotuar




Figura 4: Numri i votave për PDK-në dhe përqindja e votave të përgjithshme (sipas vitit).

LDK: Ringjallja e ngadaltë pas rënies së thellë

Partia që pas luftës kishte gjysmën e elektoratit (55,3%) ka pësuar një rënie të vazhdueshme që nga atëherë, me një kthim të vogël në 2009 dhe 2010. Rënia fillestare e LDK-së ka qenë shumë e ngadalshme (399.000 në vitin 2000 në 313.000 në vitin 2004). Në vitin 2007, LDK-ja humbi më shumë se gjysmën e elektoratit të saj, që kryesisht shkoi tek Aleanca Kosova e Re, Lidhja Demokratike e Dardanisë dhe tek Partia Reformiste ORA. Për herë të parë LDK-ja u bë forca e dytë politike në vend, pas PDK-së. Mungesa e themeluesit të LDK-së, z. Ibrahim Rugova, padyshim që ka ndikuar në ndarjen e vitit 2007, megjithatë humbja e elektoratit ka filluar mjaft herët.




Figura 5: Numri i votave të fituara nga LDK, LDD dhe AKR nga 2000-2010.

Në vitin 2007, degët lokale kanë qenë më të suksesshme sesa strukturat nacionale me rreth 20.000 vota më shumë për kryetarë sesa në garën për Kuvend (trend i kundërt nga ai i PDK-së). Pjesërisht kjo mund të shpjegohet me degët lokale të dobëta të AKR-së dhe LDD-së, që të dyja në vitin e parë të themelimit. Kanë qenë zgjedhjet e vitit 2009 kur LDK-ja filloi të rimarrë pjesë të elektoratit të vet pasi që LDD dhe AKR u dobësuan dhe pjesëmarrja në zgjedhje u rrit. Rreth 23.000 vota më shumë u hodhën në garën për kuvende komunale të vitit 2009 krahasuar me të njëjtën garë të vitit 2007 (kjo mund të shpjegohet me faktin se partitë e mëdha ka më shumë të ngjarë të kenë sukses më të mirë në garat për kryetarë komunash pasi që kjo e fundit prodhon efekt më të madh). Numrat janë rritur nga gara e ashpër për kryetar të komunës së Prishtinës, ku Isa Mustafa arriti të fitojë rreth 10.000 vota më shumë sesa LDK-ja në kuvend komunal, por edhe në komuna tjera si në Podujevë, Gjilan, Istog dhe Fushë Kosovë.

Në vitin 2010, LDK-ja e ruajti elektoratin e rifituar në vitin 2009 dhe ka fituar disa votues shtesë, me gjasë nga LDD dhe AKR. Është e diskutueshme se sa pozicioni në qeveri nga viti 2007-2010 ka ndikuar në performancën e LDK-së, por ka qenë performanca e Mustafës në Prishtinë që ka ndikuar për rifitim dhe pothuajse gjysmës së elektoratit. Pozicionimi i tij si opozitë e qeverisë ndoshta ka ndikuar në perceptimin e LDK-së si alternativa kryesore në opozitë dhe disa vota anti-PDK të koncentruhen atje. Krahasuar me garën qendrore të 2007-s, në 2010 LDK-ja ka rritur elektoratin e saj në 19 komuna, me ngritjen më të madhe në Prishtinë (13,4%) dhe Kamenicë (12,6%) por ka humbur elektorat në 11 komuna tjera, me humbjet më të mëdha në Suharekë (-12,4%) dhe Shtërpçë (-8,0%).

Pas ndarjes nga LDK, LDD ka arritur një elektorat bazë dhe të kalojë pragun prej 5%. LDD dhe AKR në performancat e tyre të para në vitin 2007 fituan më shumë se 50.000 dhe 70.000 vota, respektivisht. Ky fillim i suksesshëm i një shkallë të madhe kishte të bënte me ndarjen e elektoratit të LDK-së. Ishte më se e qartë se votuesit kërkonin alternativa të reja, po partitë e reja nuk arritën të formojnë alternativë të qëndrueshme. Në zgjedhjet e fundit kombëtare, LDD humbi më shumë se 2/3 e elektoratit të vet. AKR pësoi një trend të ngjashëm, nga performanca e parë e shkëlqyer në vitin 2007, ajo mezi kaloi pragun në vitin 2010, dhe këtë me ndihmën e një koalicioni të gjerë, ku më e rëndësishmja ishte Partia e Drejtësisë (e cila në zgjedhjet qendrore të vitit 2007 si e vetme fitoi afër 10.000). Trendi i AKR-së diskutohet më poshtë tek efektet që kanë pasur partitë e reja.

AAK: Përpykja për të thyer barrierën rajonale

Suksesi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) ka qenë shumë i lidhur me liderin e saj. Gjatë viteve të para, AAK ka pasur një elektorat të qëndrueshëm që kryesisht ka ardhur nga komunat e rajonit të Dukagjinit, por me një rritje modeste sa i përket numrit total të votave. Në vitin 2007 në zgjedhjet për Kuvend ajo ka fituar vetëm 1.200 vota më shumë sesa kur ajo garoi për herë të parë në vitin 2000. Pjesëmarrja e saj në qeverisje gjatë viteve 2004-2007 e ka mbajtur përafërsisht numrin e njëjtë të votave, pavarësisht mungesës së liderit të saj dhe asociimit të saj me keq-menaxhim. Kthimi i Haradinajt në vitin 2009 arriti që të rrisë elektoratin për zgjedhjet lokale të vitit 2009, duke i dyfishuar votat për garën për kryetarë komunash dhe duke shtuar rreth 35.000 vota për asamblatë komunale në një periudhë të shkurtër kohe. Zgjedhjet qendrore të vitit 2010 e gjetën AAK-në me liderin e saj në rigjykim dhe elektorati i saj sërish pësoi rënie të theksuar. Këto trende tregojnë në mënyrë të qartë se lideri i AAK-së ka qenë faktori më vendimtar në marrjen e përkrahjes së elektoratit gjatë kohës së shkurtër të udhëheqjes në qeveri. Elektorati i saj ka një potencial të qartë nëse i jepet mundësia që lideri i saj të bëjë fushatë gjatë procesit zgjedhor.




Figura 6: Numri i votave të fituara nga AAK dhe përqindja e votës së përgjithshme nga 2000-2010.

Suksesi i AAK-së në vitin 2009 mund të shpjgohet lehtë me kthimin e liderit të saj i cili ka qenë pjesë e fushatës zgjedhore të atij viti. E konsideruar si një nga tri partitë e mëdha, AAK-ja ka qenë po ashtu përfituese e zgjedhjeve për kryetarë komunash, dhe në vitin 2007 ajo ka pasur më shumë

vota për kryetarë komunash dhe kuvende komunale se sa për nivel kombëtar me një dallim prej 6.000 votash.

Në vitin 2009, ky efekt ka qenë edhe më i lartë. Përveç që ka arritur numrin më të madh të votave ndonjëherë, AAK mbledhi 30.000 vota më shumë në garën për kryetarë komunash sesa për kuvende komunale. Kandidatët e fortë për kryetar në Gjakovë, Suharekë, Vushtrri, Pejë dhe madje edhe në Drenas, qartazi i ndihmuan AAK-së që ta rrisë elektoratin.

Partitë e reja nuk janë më të reja

Rënia e tri partive të mëdha pjesërisht shpjegohet me rënien e pjesëmarrjes në votime, por po ashtu edhe për shkak që një pjesë e votuesve të irrituar ishin të gatshëm që të shikonin drejt opsioneve të reja. Partitë e reja u shfaqën në çdo zgjedhje që thekson faktin se skena politike në Kosovë nuk është konsoliduar prandaj kërkohej ndryshim. Përveç pragut zgjedhor, votat e fituara nga partitë e reja në çdo cikël zgjedhor, tregojnë që një pjesë e konsiderueshme e elektoratit të Kosovës është në vazhdimësi duke kërkuar alternativa të reja për të kundërshtuar tri partitë e mëdha (LDK, PDK dhe AAK).




Figura 7: Trendet e tri partive të reja performanca e të cilave u pakësua pas një fillimi të mirë.

Tri forca politike të rëndësishme kanë hyrë vullshëm në Kuvend, duke parë më pastaj se si u largohet elektorati në zgjedhjet vijuese. Shpjegimet për rënien e tyre janë të shumta, nga paaftësia e tyre për të organizuar rrjetin e degëve, deri tek shpjegimi pas të cilit rreshtohet D4D që në mungesë të një profili të dallueshëm, tipari risi shpejt zëvendësohet nga parti akoma më të reja. Disa parti mund të përvetësojnë disa nga votuesit e dëshpëruar, por në mungesë të ndjesisë se ata e kanë gjetur partinë e duhur, shumica e votuesve do të braktisin partitë për opsione të reja.

Partia Reformiste ORA ka garuar për herë të parë në zgjedhjet e vitit 2004 dhe ka arritur që të fitojë 43.000 vota (6,2%). Në zgjedhjet e vitit 2007 u shfaqën AKR dhe LDD, kështu që ORA humbi gjysmën e votave që i morri në vitin 2004. Disa votues mund ta kenë zgjedhur ORA-n për shkak të programit specifik, por qartazi shumica e kanë zgjedhur atë për shkak të rrisë, përfaqësimit të grupeve që janë ndjerë të papërfaqësuar dhe potencialit të supozuar për ndryshim. Tri vite ja humbën shkëlqimin ORA-s dhe risia herën tjetër në masë të madhe shkoi tek AKR. Për fat të keq të ORA-s, futja e pragut zgjedhor prej 5% e la atë jashtë Kuvendit.

Futja e Aleancës për Kosovë të Re (AKR) në garën zgjedhore të vitit 2007 ka ndryshuar disi balancin e partive politike. Edhe pse ajo nuk arriti që të futet në koalicionin qeverisës, AKR-ja u shfaq si

partia e tretë me 12,3% të votave në nivel kombëtar, duke tejkaluar AAK-në. AKR po ashtu është përfituese e qartë e krizës së LDK-së. Megjithatë, edhe pse në opozitë ajo nuk arriti që të rrisë votat apo të mbajë elektoratin që e ka fituar në vitin 2007. Në zgjedhjet e vitit 2009, brenda dy viteve, ajo humbi rreth 10.000 vota (krahasuar me zgjedhjet për kuvende komunale). Rënia ka vazhduar dhe AKR-ja do ta pësonte fatin e njëjtë sikur të LDD-së po të mos kishte formuar koalicion të gjerë me pesë (5) parti më të vogla dhe me individë të popullarizuar nga fusha të ndryshme. Përkundër bashkimit, Koalicioni i formuar për Kosovë të Re – KKR fitoi 3.000 vota më pak se sa që kishte AKR e vetme në vitin 2009. AKR ka rritur elektoratin vetëm në dy komuna, Gjakovë dhe Rahovec.




Figura 8: AKR dhe përqindja e votës së saj.

AKR po ashtu është partia e vetme që ka fituar më pak vota në garën për kryetarë komunash sesa për kuvende komunale në vitin 2007. Performanca e dobët në garën për kryetarë komunash me gjasë lidhet drejtpërdrejtë me efektin mazhoritar, ku partitë e vogla janë në dëm kundrejt partive të mëdha. Duke e vërejtur dobësinë, AKR u pajtua me LDD-në që të përkrahin kandidatët për kryetarë të njëra tjetrës. AKR garoi në 13 komuna për kryetarë me përkrahjen e LDD-së dhe LDD garoi në 11 komuna për kryetar me përkrahjen e AKR-së, përderisa në katër (4) komuna garuan kundër njëra tjetrës. Ky koalicion joformal solli rreth 13 % të votave në total për AKR-në dhe LDD-në.

Në zgjedhjet e fundit qendrore të vitit 2010, Lëvizja “Vetëvendosje” tejkaloi performancën e partive të reja të mëhershme, dhe nuk tregon shenja të dobësimit siç kishte tek partitë tjera. Më shumë se 88.000 vota (12%) e sollën këtë lëvizje në vendin e tretë me numër të votave. Përderisa “Vetëvendosje” ka më shumë degë lokale të themeluara dhe të zhvilluara, mbetet të shihet nëse votuesit fleksibil do ta shohin VV-në si një alternativë më e qëndrueshme nga partitë e reja të mëhershme.

BETEJA PËR VENDET E FUNDIT TË REZERVUARA

Trendet e votuesve serbë gjatë një dekade të zgjedhjeve kanë treguar ndryshime drastike varësisht nga situata politike momentale. Asnjë parti serbe nuk kishte garuar në zgjedhjet e vitit 2000. Përderisa në zgjedhjet e para qendrore të vitit 2001 dolën në votime rreth 31.000 gjykuar nga numri i votave të fituara nga koalicioni “Kthimi”. Serbët dhe pakicat tjera fituan 6,9% të votave të përgjithshme në 2001. Regjistrimi i e më shumë votuesve serbë dhe karakteri lokal i zgjedhjeve të vitit 2002, bëri që dalja e serbëve në zgjedhje të arrijë pjesëmarrjen më të lartë.




Figura 9: Numri i përgjithshëm i votave të komunitetit serb dhe komuniteteve tjera nga 2000-2010.

Në zgjedhjet pas trazirave të vitit 2004, dolën më pak se 1.200 votues serbë kurse zgjedhjet e vitit 2007 shënuan një ngritje tejet të vogël për shkak se zgjedhjet ndodhën në prag të pritjes së shpalljes së pavarësisë.

Është me rëndësi të ceket se dalja e komunitetit serb për herë të parë nuk përcjell trendet politike dhe statusit, por paralajmëron një trend të vazhdueshëm të rritjes në të ardhmen. Rritja e daljes në votim në vitin 2009 ishte kryesisht rezultat i procesit të decentralizimit. Perceptimi se pavarësia e Kosovës është e pakthyeshme ka nxitur këtë komunitet të sigurojë hisen e vetë të pushtetit. Disa serbë janë zgjedhur kryetarë të komunave në zgjedhjet lokale të vitit 2009 dhe kjo ka kontribuar me dalje më të madhe edhe në vitin 2010. Po ashtu zgjedhjet e vitit 2010 rezultuan me daljen më të lartë nga komunitet tjera të Kosovës. Komuniteti serb gjithashtu kishte daljen më të madhe që nga zgjedhjet lokale të vitit 2002.

EFEKTET E POLITIKAVE KRYESORE TË PROCESIT ZGJEDHOR

Më pak gra të zgjedhura me meritë në 2010

Kuota gjinore prej 30% vazhdimisht ka qenë veçori dalluese e zgjedhjeve në Kosovë. Perderisa politika e kuotës gjinore nuk ka ndryshuar, sistemi zgjedhor ka lëvizur nga listat e mbyllura në lista të hapura dhe prej mundësisë për të zgjedhur një kandidat në atë për të zgjedhur disa kandidatë, gjë që ka ndërlikuar zbatimin e kuotës.

Politika në Kosovë është e dominuar nga burrat por aplikimi i kuotës gjinore nuk ishte bërë çështje kontraverse. Dilemat e tanishme të ngritura nga disa përfaqësues të komunitetit ndërkombëtar përqendrohen rreth faktit se zëvendësimi i meshkujve me më shumë vota nga gra me më pak vota është problematik. Vlen të theksohet se kjo dilemë asnjëherë nuk është ngritur nga 21-24 meshkuj të cilët i kanë humbur mandatet e tyre si deputetë për shkak të grave më me pak vota.

Aplikimi i listave të hapura tani e ka bërë të mundur të matet përqindja e deputeteve të cilat kanë fituar me meritë dhe ato që janë zgjedhur me kuotë. Rezultatet e zgjedhjeve qendrore të 2007-s tregojnë se 16 deputete (nga gjithsej 37) janë zgjedhur me meritë kurse 21 deputete tjera kanë marrë ulëse në Kuvendin e Kosovës duke ju falënderuar kuotës gjinore. Në vitin 2010, tri gra më shumë se në vitin 2007 kanë përfituar nga kuota gjinore kurse vetëm 14 deputete janë zgjedhur me meritë.

Një vështrim më i thellë në performancën e grave në secilën parti tregon se vetëm në LDK dhe deri diku në SLS ka pasur përmirësim në trendet e zgjedhjes së grave me meritë. Në vitin 2007, katër (nga tetë) deputetet e LDK-së ishin zgjedhur me meritë përderisa në zgjedhjet e vitit 2010 ky numër u ngrit në shtatë nga nëntë deputetet e zgjedhura të LDK-së. Në AAK vetëm nga një deputete ka arritur të zgjedhet me meritë (1 nga 3 në 2007, 1 nga 4 në 2010). Mbi gjysma e deputeteve të PDK-së ishin të zgjedhura me meritë në 2007 përderisa në vitin 2010 ra në vetëm 2 nga 11. Nga tri deputete të AKR-së (nga 4 total) të zgjedhura me meritë në vitin 2007, ky numër ra në një (nga 3) në 2010. Kampioni i grave meritore ishte Lista e Bashkuar Serbe ku të dy deputetet u zgjodhën me meritë.




Figura 10: Numri i grave të zgjedhura nga kuota dhe me meritë në vitin 2007 dhe 2010




Figura 11: Përqindja dhe numri i deputeteve me meritë në parti.

Gravitacioni kah lideri




Figura 12: Shtylla e parë: përqindja e votuesve të cilët shënuan (përzgjedhën) edhe Kryetarin e partisë si një nga pesë kandidatët e mundshëm. Shtylla e dytë: votat e Kryetarit të partisë si përqindje e të gjitha votave të fituara nga të gjithë kandidatët.

Ende të varur në udhëheqës

Identiteti i partive politike në dekadën e fundit ka qenë ngushtë i lidhur me identitetin e udhëheqësve të tyre. Partitë kosovare janë të reja dhe në mungesë të ideologjive politike, ato bëhen lehtë të kontrollueshme dhe performanca e tyre është varet në suksesin e udhëheqësit.

Mirëpo jo të gjitha partitë udhëheqene nga liderët themeltarë. LDK ka kaluar përmes një procesi të trazuar por tani ka zgjedhur një udhëheqës të ri që ka rikthyer trendin. LDK është e vetmja parti e udhëhequr nga një udhëheqës i cili nuk është edhe themelues por që ka fituar në një proces të brendshëm demokratik. Në zgjedhjet e fundit qendrore të vitit 2010, tre nga katër votuesit e LDK-së kanë përzgjedhur në fletëvotim edhe udhëheqësin e ri, Isa Mustafa, si një nga pesë përzgjedhjet e mundshme për kandidatë të Kuvendit të Kosovës. Më shumë se 18% e të gjitha votave brenda partiake (duke trajtuar secilën votë për një kandidat si një votë) nga elektorati i LDK-së ishin për Isa Mustafën. Ky është një indikacion se elektorati i LDK-së në masë të madhe ka aprovuar udhëheqësin e ri por mund edhe të jetë tregues se LDK është ende e varur në udhëheqës të saj. Mbetet të shihet nëse ky trend tregon që LDK mbetet e varur në udhëheqës me një emër të ndryshëm apo ndoshta pas vdekjes së Rugovës, partitë duhet të bëhen më demokratike për të mbijetuar dhe tash LDK ka filluar të vjelë përfitimet nga ky proces.

Udhëheqësit e PDK-së dhe AAK-së u përzgjedhën nga më shumë se 70% të elektoratit të partive të tyre. Ata vazhdojnë të jenë të pa-sfidueshëm që nga themelimi i partive të tyre dhe sigurisht nuk janë duke humbur elektorat. Haradinaj dhe Thaçi kanë fituar 17% dhe 16% nga të gjitha votat për kandidatët në fletëvotimet e partisë dhe ky është një tregues i qartë se lidershipi ka peshë në partitë e tyre akoma.

Edhe udhëheqësi i partisë së re, Lëvizja Vetëvendosje, është votuar nga 66% e të gjithë elektoratit të kësaj partie dhe ngjashëm me Thaçin dhe Haradinajn ka fituar rreth 16% të të gjitha përzgjedhjeve në fletëvotime nga elektorati i VV-së. Mirëpo Vetëvendosje është një parti që proklamon të ketë vendimmarrje konsensuale dhe një platformë politike konsistente që mund të shërbejë si një alternativë për të tërhequr votuesit drejt lëvizjes. Udhëheqësi i AKR-së, Behxhet Pacolli, është votuar nga 57% e votuesve të Koalicionit për Kosovë të Re (KKR) që shpjegohet me faktin se janë bashkaur në koalicion gjashtë partive në zgjedhjet e vitit 2010 dhe është e natyrshme që votuesit e partive më të vogla të këtij koalicioni të zgjedhin të preferuarit e tyre.

Dukja e fletëvotimeve si problem

Trendet e mësipërme mundën po ashtu të shpjegohen nga natyra teknike e dizajnit të fletëvotimit dhe disa efekte që drejtpërdrejtë burojnë nga sistemi zgjedhor i aplikuar. Një sistem me lista të hapura që trajton Kosovën si një zonë zgjedhore natyrisht favorizon udhëheqësit. Me 110 mundësi për zgjedhje në fletëvotim (ku votuesit duhet të i referohen edhe fletushkës që tregon se cili numër korrespondon me emrin e kandidatit) e bënë shumë më të lehtë që të votohet për prijësit e listës.

Në mungesë të zonave, mundësia e përzgjedhjes së më shumë se një personi ishte iniciuar në mënyrë që të mënjanohet dilema e votuesve që të zgjedhin ose udhëheqësin e partisë ose personin lokal të preferuar. Sistemi me një përzgjedhje në fletëvotim do ta vinte lidershpin qendror kundër disa udhëheqësve me ndikim rajonal.

Ishte vlerësuar se më shumë përzgjedhje do të mënjanonin konkurrencën e padrejtë si dhe do të rritnin mundësinë e grave dhe udhëheqësve lokal për të mbledhur më shumë vota. Mirëpo, megjithatë sistemi aktual favorizon udhëheqësit me ndikim që kanë qasje në media, në fonde dhe praktikisht krijon një garë me dy nivele.

Listat e hapura çdoherë e më shumë çmohen nga votuesit

Listat e hapura ishin iniciuar në zgjedhjet e vitit 2007 dhe kanë ndryshuar mënyrën se si kandidatët përzgjidhen, si ata bëjnë fushatë dhe si pozicionohen në Kuvend kur të fitojnë mandatin. Listat e hapura kanë qenë një mundësi për votuesit të vendosin se cilët kandidatë të partive politike ti përfaqësojnë ata.

Të dhënat e prezantuara tregojnë se listat e hapura kanë pasur një ndikim pozitiv duke mundësuar që 40% e anëtarëve të Kuvendit të Kosovës të zgjedhen duke ju falënderuar listave të hapura. Në anën tjetër 60% e të zgjedhurve në Kuvend do të ishin zgjedhur qoftë me lista të mbyllura apo të hapura. Ky efekt është më i dukshëm tek partitë e mëdha ku 48% e deputetëve nga këto parti janë zgjedhur duke



Figura 13: Numri i deputetëve të zgjedhur nga listat e hapura dhe atyre që do të ishin zgjedhur qoftë me lista me hapura qoftë me të mbyllura në vitin 2010.

Gati gjysma e deputetëve të katër partive të mëdha nuk do të ishin zgjedhur nëse listat e partive do të ishin përgatitur në bazë të preferencave të udhëheqësve të partive.

ju falënderuar listave të hapura.

Për më tepër, numri i deputetëve të zgjedhur përmes listave të hapura është në rritje tek partitë e mëdha. LDK ka pasur përqindjen më të madhe të deputetëve të zgjedhur nga listat e hapura në 2007 dhe kjo është e kuptueshme duke marrë parasysh udhëheqësinë e kontestuar të LDK-së në atë kohë. Përqindja e deputetëve të LDK-së të përzgjedhur nga listat e hapura u rrit nga 7 (prej gjithsej 27) në 11 (prej 27) në vitin 2010. Përqindja e fituesve nga listat e hapura në radhët e PDK-së u dyfishua nga 9 në 18 (24% në 53%) që tregon se preferencat e partisë nuk përputhen me preferencat e votuesve. Përzgjedhjet e AAK-së dhe AKR-së duken më në vijë me preferencat e votuesve të tyre ku përkatësisht vetëm një (1) dhe dy (2) deputetë të tyre janë zgjedhur me lista të hapura. Votuesit e AAK-së kanë bërë progresin më të madh në përzgjedhjen me listat të hapura, ku nga 10% (një deputet nga 10)

Më shumë fitues nga listat e hapura




Figura 14: Përqindja e deputetëve të zgjedhur përmes listave të hapura - 2007 dhe 2010.

në 45% (5 deputetë nga 11). E vetmja parti që ka pasur më së pakti përfitues nga listat e hapura në vitin 2010 ka qenë AKR, dhe kjo me gjasë për shkak të zvogëlimit të numrit të deputetëve. Shihet qartë se ndikimi i listave të hapura është më i madh kur ka më shumë ulëse për tu ndarë, pra ndikimi është më i vogël tek subjektet më të vogla.

Vetëvendosje qëndron në të njëjtin nivel me LDK-në dhe AAK-në për nga përfituesit e listave të hapura me 6 nga 11 deputetët e saj të zgjedhur përmes listave të hapura.

Votimi i shumëfishtë dhe fletëvotimet e dëmtuara

Jo të gjithë votuesit kanë shfrytëzuar pesë mundësitë e përzgjedhjes së kandidatëve brenda fletëvotimit. Disa video dhe shumë njerëz dëshmojnë se kjo mundësi është keqpërdorur nga komisionerët



Figura 15: Nga pesë përzgjedhjet e mundshme të kandidatëve për deputet në 2010.

të tjerat duke filluar nga 4.02 shënjime e deri në 4.45 shënjime mesatare për një fletëvotim të vlefshme. Disa parti mund të kenë votues më të motivuar dhe më të arsimuar por kjo po ashtu mund të tregojë që disa parti mund të kenë komisionerë që kanë shtuar shënjime në fletëvotime. Partia Demokratike e Kosovës del të ketë mesataren më të lartë të shënjimeve në fletëvotime, 4.45 shënjime (përzgjedhje) që do të thotë se diku 9 nga 10 votues të PDK-së kanë përdorur të gjitha pesë mundësit për kandidat. Përrjashtuar këtu partinë FER, sa më i lartë numri i komisionerëve (që përket me madhësinë e partisë) aq më i lartë del të jetë mesatarja e shënjimeve në fletëvotime për atë parti. LDD dhe Vetëvendosje me më pak komisionerë del të kenë mesatarisht diku rreth

e partive për të shtuar votat për kandidatët që ata i kanë preferuar. Fletëvotimet konsiderohen të vlefshme nëse është shënjuar vetëm një kandidat apo edhe asnjëri prej tyre përderisa një parti është shënjuar qartë. Natyrisht, disa fletëvotime kishin më pak se pesë kandidatë të shënjuar.

Nëse analizohet ky fenomen vërehet se disa parti politike mesatarisht kishin më shumë përzgjedhje në fletëvotime se




Figura 16: Shkalla jashtëzakonisht e lartë e fletëvotimeve të dëmtuara për zgjedhje të kryetarëve në Shtime dhe Ferizaj.

4 shënjime në fletëvotime. Kjo është një fushë ku ka nevojë për përmirësime të mëdha dhe që është nën përgjegjësinë e KQZ-së, e cila duhet të shqyrtojë mundësitë e caktimit të komisionerëve në lokacione të ndryshme nga ato që vijnë.

Në vitin 2009, për herë të parë KQZ filloi të raportojë fletëvotimet e dëmtuara. Para vitit 2009, ka të ngjarë që fletëvotimet e dëmtuara janë futur në të njëjtën kategori me ato të pavlefshmet prandaj kjo kategori nuk mund të krahasohet me zgjedhjet e mëparshme. Në zgjedhjet e fundit të 2010, fletëvotimet e dëmtuara janë në një mesatare të ulët prej 0,17% e të gjitha votave.

Një analizë më e thellë në fletëvotimet e dëmtuara të zgjedhjeve të 2009 qartazi tregon vandalizëm me fletëvotimet për kryetarë komunash. Logjikisht, duhet të ketë më shumë fletëvotime të dëmtuara për kuvende komunale pasi që këto fletëvotime janë më të komplikuar se sa ato për kryetarë komune.

Në përgjithësi zgjedhjet për kryetar komunash në 2009 rezultojnë me më shumë fletëvotime të dëmtuara (0,35%) krahasuar me ato për kuvende komunale (0,27%). Përveç në Shtime dhe Ferizaj, të gjitha komunat tjera kishin një numër më të vogël të fletëvotimeve të dëmtuara për kryetar komune sesa për kuvende komunale. Në Shtime dhe Ferizaj fletëvotimet për kryetar komune të dëmtuara ishin shumëfish më të mëdha se mesatarja e Kosovës. Përafërsisht 4,5% e të gjitha fletëvotimeve për kryetar komune të Shtimes ishin të dëmtuara. Kjo nuk mund të arsyetohet me nivelin e ulët të arsimimit të votuesve në Shtime për shkak se shkalla e dëmtimit të fletëvotimeve për kuvend komunal në po të njëjtat komuna ishte më e ulët se mesatarja e Kosovës. E njëjta gjë ndodhi edhe në Ferizaj dhe afërsia gjeografike e këtyre dy komunave tregon një mësim që mund të jetë marrë nga njëra komunë në tjetrën dhe që shpresohet të mos përhapet në të ardhmen në komunat tjera. Kjo tregon qartazi se në këto dy komuna ka pasur grupe të organizuara të një partie që kanë dëmtuar fletëvotimet e partive tjera.

Fletëvotimet e pavlefshme: Përmirësim gradual

Shkalla e fletëvotimeve të pavlefshme ka lëvizur vazhdimisht dhe në momente të caktuara ka arritur nivel alarmant. Shkalla e votave të pavlefshme është çështje e ndjeshme pasi që një shkallë e lartë tregon që shumë votues gjysmë-analfabetë kanë humbur mundësinë e tyre për të ushtruar një të drejtë demokratike dhe shfaq potencial për keqpërdorime. Ndryshimet në rregullat zgjedhore gjatë dekadës së fundit kanë pasur një efekt të theksuar në nivelin e fletëvotimeve të pavlefshme. Me komplikimin e sistemit, shkalla e votave të pavlefshme është rritur, por kur procedura të caktuara të votimit u vazhduan, shkalla e votave të pavlefshme ra. Në këtë llogaritje nuk ka ndihmuar fakti që autoritetet përgjegjëses kanë ndryshuar klasifikimin se çfarë e bën një fletëvotim të pavlefshëm.

Fletëvotime të pavlefshme				
Viti i zgjedhjeve		Mes.	Më e larta	Më e ulëta
Lokale	2000	4.7%	Fushë Kosovë (9.7%)	Istog (2.5%)
Qendrore	2001	1.5%	Leposaviq (2.7%)	Deçan (0.9%)
Lokale	2002	1.2%	Dragash (3.4%)	Deçan (0.8%)
Qendrore	2004	1.0%	Dragash (2.0%)	Deçan (0.6%)
Qendrore	2007	5.6%	Ferizaj (7.7%)	Drenas (3.6%)
Lokale	2009	7.9%	Ferizaj (11.7%)	Novobërdë (3.6%)
Kryetar	2009	1.5%	Drenas (5.6%)	Vushtrri (0.6%)
Qendrore	2010	3.8%	Ranillug (7.6%)	Istog (2.5%)

Nuk është për t'u çuditur që votat e pavlefshme arritën gati në 5% në zgjedhjet e viti 2000 për shkak se këto ishin zgjedhjet e para. Shkalla e votave të pavlefshme kishte rënë në 2001, 2002 dhe 2004 kryesisht sepse ishin aplikuar listat e mbyllura por edhe për faktin se kishte një vetëdijesim më të madh se si të votohet.

Zgjedhjet e vitit 2007 treguan një nivel të paparë të votave të pavlefshme për dy arsye kryesore: (a) tri lloj zgjedhjesh u mbajtën në të njëjtën kohë, dhe (b) aplikimi i listave të hapura me 10 mundësi të përzgjedhjes së kandidatëve. Gati 57.000 (apo 6,1% nga dalja në zgjedhje) të fletëvotimeve u vlerësuan si të pavlefshme dhe përafërsisht 22.000 fletëvotime ishin të zbrazëta që bëjnë 3,8% e të gjitha fletëvotimeve.

Fletëvotimet zbrazëta				
Viti i zgjedhjeve		Mes.	Më e larta	Më e ulëta
Qendrore	2001	0.44%	Leposaviq (0.9%)	Prishtinë (0.3%)
Lokale	2002	0.45%	Podujevë (2.0%)	Prishtinë (0.2%)
Qendrore	2004	0.39%	Malishevë (2.3%)	Drenas (0.08%)
Qendrore	2007	3.50%	Lipjan (7.4%)	Skenderaj (0.4%)
Lokale	2009	1.95%	Junik (4.3%)	Ranillug (0.18%)
Kryetar	2009	0.64%	Klllokot (32.9%)	Skenderaj (0.2%)
Qendrore	2010	0.63%	Junik (1.5%)	Ranillug (0.12%)

Listat u mbajtën të hapura në vitin 2009 por mundësia e plotësimeve për kandidatë u zvogëluar në pesë. Niveli i fletëvotimeve të pavlefshme sërish u rrit në 8,4% përderisa fletëvotimet e zbrazëta ranë në 2,1%. Vlen të përmendet se niveli i votave të pavlefshme është shumëfish më i lartë në votimet me kusht.

Zgjedhjet për kryetar komunash në të njëjtën kohë (2009) rezultuan me katër herë më pak vota të pavlefshme (2,3% duke përfshirë fletëvotimet e zbrazëta).

Zgjedhjet e fundit të 2010-së treguan se niveli i votave të pavlefshme u përgjysmua që shpjegohet kryesisht me vazhdimin e të njëjtit sistem zgjedhor dhe me faktin se ishin mbajtur vetëm një palë zgjedhje. Kjo dëshmon se votat e pavlefshme nuk mund të përdoren më si argument kundër listave të hapura.

Mesatarja e fletëvotimeve të zbrazëta kanë pësuar një ngritje drastike nga 0,4-0,6% në 3,5%. Komuna e Prishtinës kishte një nga nivelet më të ulëta të fletëvotimeve të zbrazëta por ky prestigj tanimë i takon komisionerëve efikas të Skenderajt.

Fletëvotime të pavlefshme, zbrazëta dhe të dëmtuara




Figura 17: Përqindja e fletëvotimeve të pavlefshme dhe të zbrazëta nga 2000-2010.

PSE AKOMA EKZISTOJNË FLETËVOTIMET ME KUSHT DHE ATO ME POSTË?

Zërat që mbrojnë votat me kusht janë të pakët sot, kryesisht për shkak të potencialit të madh të tyre për manipulim dhe kohës së madhe që shpenzohet për t'i numëruar. Mirëpo problemet me listën e votuesve e bëjnë të domosdoshme përdorimin e votimit me kusht.

Përkundër problemeve që sjellin votat me kusht, kjo mundësi ende ekziston për votuesit. Para numërimit, secili

fletëvotim me kusht verifikohet nëse votuesi nuk ka votuar më herët në ndonjë lokacion tjetër. Nëse një votues i cili voton me kusht vërtetohet të ketë votuar në një tjetër qendër të votimi, fletëvotimi me kusht i tij/saj refuzohet. Nëse një person voton për dikë tjetër (sikurse edhe ndodhë shpesh në ato komuna ku dalja kalon 60%), ka rrezik të refuzohet pikërisht vota me kusht e votuesit të vërtetë i cili ka votuar në një lokacion tjetër. Rreth një e treta e fletëvotimeve me kusht janë refuzuar në vitin 2001 përderisa shkalla e refuzimit në vitin 2010 ky nivel ka rënë në një të pestën e votave me kusht.




Figura 18: Përqindja e votave me kusht.




Figura 19: Shkalla e pranimit të votave me kusht.

Në 2010 votat me kusht mesatarisht kanë qenë 4,3% të votës së përgjithshme në komunë. Në të gjitha zgjedhjet, fletëvotimet me kusht më së shumti janë përdorur në komunat me shumicë serbe,

Fletëvotimet me kusht të zgjedhjeve të vitit 2001 përbënin mesataren prej 6,3% të të gjitha fletëvotimeve të hedhura në kuti duke filluar nga Kaçaniku me nivelin më të ulët (4,8%) e deri tek Leposaviqi me nivelin më të lartë të votave me kusht (12,5%). Niveli i këtyre votave rezultoi në rënie të vazhdueshme në 3,5% mesatare për komunë në vitin 2009.

Fletëvotimet me kusht				
Viti i zgjedhjeve		Mes.	Më e ulëta	Më e larta
Qendrore	2001	6.33%	Kaçanik (4.8%)	Leposaviq (12.5%)
Lokale	2002	4.91%	Shtime (2.3%)	Novobërdë (12.8%)
Qendrore	2004	5.62%	Deçan (2.4%)	Zveçan (44.0%)
Qendrore	2007	5.38%	Deçan (2.3%)	Leposaviq (72.8%)
Lokale	2009	3.47%	Skenderaj (1.7%)	Zveçan (35.7%)
Qendrore	2010	4.34%	Deçan (1.9%)	Leposaviq (47.8%)

kryesisht në tri komunat në veri të Kosovës ku rrethanat për votim ishin kryesisht të rrezikshme si dhe për shkak të lëvizjeve të popullatës serbe pas luftës nga komunat ku ishin regjistruar në veri të Kosovës.

Fletëvotimet përmes postës			
Lloji i zgjedhjeve	Viti	Gjithësejt me postë	% e votave
Qendrore	2001	27,788	3.46%
Qendrore	2004	3,806	0.54%
Qendrore	2007	6,233	0.99%
Kryetar Komune	2007	5,491	0.93%

Një kategori tjetër e votave që është edhe më e panevojshme se sa votimi me kusht, është votimi përmes postës. Ka shumë votues të regjistruar që jetojnë jashtë vendit dhe mundësia për votim me postë ekziston që nga viti 2001. Qëllimi i ofrimit të këtij lloji votimi të kushtueshëm dhe shumë pak të përdorur është të mos u merret e drejta e votës atyre që jetojnë jashtë vendit. Votimi me postë fillon disa javë më përpara me qëllim që këto vota të mund të numërohen në atë ditë kur numërohen edhe votat e rregullta. Për zgjedhjet qendrore të vitit 2001 ky lloj votimi ishte përdorur nga më pak se 28.000 votues të regjistruar në diasporë që përbënte rreth 3,5% të daljes së përgjithshme në zgjedhje. Pasi që KQZ nuk publikon rregullisht të dhënat e votave me postë, nuk mund të tregohet niveli i këtyre votave në zgjedhjet 2002, 2007 për kuvende komunale, si dhe 2009 e 2010. Votimi me postë është dyfishuar nga 0.5% në vitin 2004 në gati 1% të votave të përgjithshme në vitin 2007.

Marrë parasysh numrin e madh të resurseve dhe kohës për të ofruar këtë lloj votimi që përdoret nga më pak se 1% e votuesve, ka pasur shumë zëra që kanë bërë thirrje për heqjen e këtij lloj votimi së paku për zgjedhjet komunale.

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

324(496.51)2000/2010

Zbërthimi i trendeve zgjedhore 2000-210 / [Instituti
Demokrasi për Zhvillim]. – Prishtinë : Instituti
Demokrasi për Zhvillim, 2011. – 32 f. : ilustr. me ngjyra ;
26 cm.

ISBN 978-9951-608-00-8



Mbështetur nga:



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE



INSTITUTE FOR
Sustainable
Communities

ISBN 978-9951-608-00-8



9 789951 608008